



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1325 Prot.

Tiranë, më 20 /09 /2021

V E N D I M

Nr.176 , Datë 20 /09/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 52 Regj, datë 01.04.2021, paraqitur nga ankuesi F.T, kundër Bashkisë Selenicë, me pretendimin se është diskriminuar në të drejtën për punësim, për shkak të “*bindjeve politike*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi shpjegon se, ka qenë i punësuar në Bashkinë Selenicë, Njesia Administrative Sevaster, në pozicionin inspektor finance, bazuar në kontratën individuale të punës nr. 678/1 prot., datë 21.03.2018. Këtë detyrë ankuesi deklaron se e ka kryer me korrektësi dhe profesionalizëm dhe nuk ka marrë kurrë ndonjë masë disiplinore gjatë periudhës që ka punuar pranë Bashkisë Selenicë.

Ankuesi shpjegon se, në mënyrë të papritur Kryetari i Bashkisë Selenicë me shkresën nr. 1151 prot., datë 01.04.2020 ka nxjerrë urdhrin nr. 75 datë 01.04.2020 “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës*”, me motivacionin “*suprimim i pozicionit*”, urdhër i cili i është komunikuar më datë 15.04.2020. Megjithë përpjekjet nga ana e tij, ankuesi shprehet se nuk është pritur për bisedime nga Kryetari i Bashkisë apo ndonjë punonjës tjetër.

Ankuesi pretendon se motivacioni i largimit nga puna është një justifikim, pasi arsyeja e vërtetë e largimit të tij është për motive politike, pasi ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike. Angazhimin e tij me këtë forcë politike, ankuesi deklaron se e ka kryer vetëm jashtë orarit të punës dhe jo në ambientet e punës.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesi shpjegon se, është punonjësi më i kualifikuar për sa i përket arsimit dhe përvojës në punë dhe pavarësisht këtij fakti ai është larguar nga puna, ndërkohë që punonjës të tjerë me arsim të mesëm vazhdojnë punën. Në lidhje me arsimimin e tij ankuesi, deklaroi se është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, pranë Universitetit Ismail Qemali, Vlorë.

Këto sjellje dhe veprime të Kryetarit të Bashkisë Selenicë z. Pëllumb Binaj, ankuesi i konsideron sjellje diskriminuese për shkak të bindjeve politike, pasi haptazi dhe në shkelje të ligjit ai është kufizuar dhe përjashtuar nga e drejta për punësim. Si pasojë e këtyre sjelljeve diskriminuese ankuesi pretendon se i kanë ardhur pasoja të rënda morale, psikologjike, shëndetësore dhe ekonomike.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Bashkisë Selenicë, për shkak të bindjeve politike dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 562/2 prot., datë 06.04.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Selenicë, në lidhje me pretendimet e parashtruara nga ankuesi.
2. Me shkresën nr.1052/1 prot., datë 15.04.2021², Bashkia Selenicë ka kthyer përgjigje duke parashtruar sa vijon:

E gjithë praktika e ndjekur për rastin e ankuesit, ka qenë mbi respektimin e detyrimeve kontraktuale. Bashkia sqaron se, pozicioni i punës i ankuesit ka qenë punonjës për financën pranë

² Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 562/4 prot., datë 20.04.2021.

Njësisë Administrative Sevaster, në Drejtorinë e Financës. Nga një marrëveshje e lidhur midis Bashkisë Selenicë dhe Shërbimit Postar Vlorë, punonjësi i shërbimit postar do të lehtësonte punën nëpër njësi për bashkinë, duke përfshirë edhe kryerjen e detyrës së financierit të çdo njësie administrative.

Bashkia, sqaron se, mungesa e detyrave në pozicionin e punës së punonjësit kanë sjellë si pasojë suprimimin e pozicionit dhe shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të justifikuar, jo diskriminuese nga ana e punëdhënësit.

3. Me shkresën nr.562/1 prot., datë 06.04.2021, Komisioneri ka kërkuar informacione shtesë nga ankuesi, kryesisht në lidhje me pretendimet e tij se largimi i tij nga puna ka ndodhur për shkak të bindjeve të tij politike. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 562/3 prot., datë 19.04.2021, ankuesi ka dërguar informacionin e kërkuar duke parashtruar ndër të tjera se:

Ai është anëtar i Partisë Demokratike qysh prej viteve 90, për të cilën ka depozituar edhe kartën e anëtarësisë pranë këtij subjekti politik. Gjithashtu, sipas vërtetimit me nr. 297 prot., datë 12.04.2021, lëshuar nga dega e PD Vlorë, depozituar si provë, pasqyrohet angazhimi në strukturat e këtij subjekti politik. Pra, vërtetohet se aktiviteti dhe angazhimi politik ka qenë i ekspozuar në ambiente publike të hapura, fakte të cilat e identifikojnë lehtësisht ankuesin mbi përkatësinë e bindjeve politike.

Ankuesi parashtron gjithashtu se, në qershor të vitit 2019 në krye të Bashkisë Selenicë ka ardhur z. Pëllumb Binaj, i mbështetur prej Partisë Socialiste, i njohur prej shumë vitesh për angazhimin e tij në këtë subjekt, i cili nisi të bëjë largime nga puna për punonjës të kësaj bashkie, të atyre që ishin me bindje politike të kundërta. Ankuesi deklaroi se, Kryetari i Bashkisë ka patur gjithmonë dijeni për bindjet e tij politike, ashtu siç ka edhe ai për atë, dhe pikërisht për këtë arsye e ka larguar nga puna, pasi nuk ekziston asnjë arsye tjetër dhe se motivacioni në urdhrin e largimit është i pabazuar dhe në kundërshtim me çdo procedurë ligjore.

4. Ankuesi ka paraqitur kundërshtimet e tij në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga Bashkia Selenicë, në rrugë elektronike dhe postare, respektivisht në datë 01.05.2021 dhe 04.05.2021³, duke theksuar ndër të tjera se, pretendimi se ka qenë marrëveshja midis Bashkisë Selenicë dhe Shërbimit Postar Vlorë, shkak që ka çuar në suprimimin e punës së mbajtur nga ankuesi, është vetëm një justifikim me qëllim abuziv. Ankuesi sqaron se, punonjësi i Shërbimit Postar Vlorë do të kryejë vetëm një nga shumë detyrat që kryheshin nga ana e tij si specialist finance, pra ai do të bënte arkëtimin e disa taksave ndërsa detyrat e tjera të financës duhet të kryhen nga financieri, atëherë kush kryen këto detyra pas largimit të tij nga puna.
5. Me shkresën nr. 671 prot., datë 21.04.2021, Komisioneri kërkoi informacion nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në vijim KQZ), në lidhje me pretendimet e ankuesit mbi angazhimin e

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.671/2 prot.

tij politik. Me shkresën nr.4201/1 prot., datë 03.05.2021, KQZ informoi se, ankuesi ka qenë anëtar i Grupeve të Numërimit të Votave (GNZ) të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 84, Qarku Vlorë, propozuar nga Partia Demokratike me vendimin nr.118, datë 25.06.2017 “për emërimin e anëtarëve të GN-ve”, në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25.06.2017.

6. Me shkresën nr. 725 prot., datë 06.05.2021, pas analizimit të shpjegimeve dhe akteve të vendosura në dispozicion nga ana e Bashkisë Selenicë, Komisioneri kërkoi nga kjo e fundit plotësimin e informacionit, i cili nuk ishte vendosur në dispozicion i plotë. Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr.1393/1 prot., datë 18.05.2021⁴, Bashkia Selenicë ktheu përgjigje duke sqaruar se:

Referuar strukturës për vitin 2020, para ndryshimeve me urdhër, pozicioni për punonjës finance ka qenë vakant në Njësinë Administrative Brataj, në Njësinë Administrative Armen dhe në Njësinë Administrative Kotë, ndërsa në Njësinë Administrative Vllahinë, punonjësi i Financës ka kaluar në pozicionin e punonjësit të tatimeve. Bashkia informoi se, ankuesi e ka kundërshtuar largimin nga puna edhe në gjykatë.

7. Me shkresën nr. 827 prot., datë 31.05.2021, Komisioneri kërkoi informacion shtesë nga ana e Bashkisë Selenicë, por kjo e fundit nuk vendosi në dispozicion informacionin e kërkuar brenda afatit.
8. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁵, të ndryshuar dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, por edhe për të administruar të gjithë informacionin e kërkuar, me shkresën nr. 896 prot., datë 11.06.2021, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 22.06.2021. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 22.06.2021, me pjesmarrjen e të dy palëve, ankuesit i cili ishte personalisht prezent dhe Bashkisë Selenicë, përfaqësuar nga M.H, sipas autorizimit nr. 966 prot., datë 21.06.2021, lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë. Gjatë seancës dëgjimore palët mbajtën të njëjtin qëndrim që kishin përcjellë pranë Komisionerit nëpërmjet komunikimit shkresor.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesi dhe përfaqësuesi i Bashkisë Selenicë depozituan kopje të vendimit nr. 710, datë 28.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me anë të të cilin gjykata kishte vendosur ndër të tjera se zgjidhja e kontratës së punës me paditësin ishte bërë në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara nga ana e Bashkisë Selenicë dhe se kjo e fundit nuk kishte respektuar procedurën dhe afatet e njoftimit, duke i njohur ankuesit dëmshpërblimet përkatëse sipas Kodit të Punës. Nga shqyrtimi i vendimit gjyqësor, nuk rezulton që pjesë e kërkimeve para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të jetë pretendimi për diskriminim. Pra, ankuesi ka zgjedhur që të mos kërkojë para gjykatës kërkimin për diskriminim që ka paraqitur për trajtim

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 725/1 prot datë 26.05.2021.

⁵ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

para Komisionerit në këtë ankesë. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se çështja objekt shqyrtimi që ankuesi ka paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe çështja objekt shqyrtimi pranë Komisionerit nuk kanë mbivendosje.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ka parashikuar në nenin 34, pika 1, të tij se, çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim mund të paraqesin kërkesë padi përpara gjykatës kompetente, ndërsa bazuar në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se, paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesë padi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës. Nga ana tjetër, bazuar në nenin 32/1/a të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë që të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “*Për Barazinë Gjinore në Shoqëri*”.

Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë pengesë ligjore për të marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga ankuesi F.T.

9. Me shkresën nr. 827/1 prot., datë 08.07.2021 dhe në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Selenicë plotësimin e informacionit. Me shkresën nr. 2173/1 prot., datë 22.07.2021⁶, Bashkia Selenicë dërgoi informacionin e kërkuar.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi F.T, ka qenë punonjës pranë Bashkisë Selenicë dhe ka punuar në pozicionin e punës “specialist finance”, pranë Njesisë Administrative Sevaster. Ankuesi ka filluar punë pranë Bashkisë Selenicë në bazë të urdhrin nr.34, datë 21.03.2018, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë në pozicionin e punës “inspektor finance” Njësia Administrative Sevaster. Për rregullimin e marrëdhënieve të punës ankuesi dhe Bashkia Selenicë kanë nënshkruar kontratën individuale të punë me nr. 678/1 prot., datë 21.03.2018, me afat të përcaktuar prej datës 21.03.2018 deri në datë 20.06.2018. Marrëdhëniet e punës midis ankuesit dhe bashkisë kanë vazhduar edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar në kontratë dhe për rrjedhojë kjo kontratë konsiderohet e lidhur me afat të pacaktuar.

Me urdhrin nr. 14, datë 15.01.2020 “*Mbi strukturën organike për vitin 2020 dhe nivelin e pagave të punonjësve*”, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, rezulton se pozicioni i punës i mbajtur nga ankuesi

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 827/2 prot datë 26.07.2021.

sipas strukturës së miratuar për vitin 2020, është “*Punonjës finance Sevaster*”, pjesë e Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Shërbimeve Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

Me urdhrin nr. 35, datë 20.02.2020 “*Për ndryshim në strukturën e vitit 2020*”, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, është urdhëruar kryerja e procedurave ligjore për ndryshimet në strukturën e Bashkisë Selenicë me nr. 14, datë 15.01.2020, e cila ka hyrë në fuqi në datën 20.01.2020, duke bërë suprimimet e pozicioneve të specialistit të financës në Njësitë Administrative Sevaster, Brataj, Armen, Vllahinë dhe Kotë.

Me urdhrin nr. 75, datë 01.04.2020 “*Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës*”, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënies të punës për punonjës F.T, specialist finance, pranë Njësisë Administrative Sevaster, Bashkia Selenicë, me motivacionin “*suprimim i pozicionit*”.

Ankuesi e kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se ndërprerja e marrëdhënies të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai është anëtar i Partisë Demokratike dhe se pretendimi i bashkisë në lidhje me suprimimin e pozicionit të punës është një justifikim me qëllim abuziv.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike,

që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu *pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*.

Bazuar në pikën 5, germa “c”, të nenit 9, të Kodit të Punës, parashikohet se: “*Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit e marrëdhënieve të punës;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim dhe më konkretisht në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Selenicë pretendoi se, zgjidhja e kontratës së punës së ankuesit është bërë për shkak të suprimimit të vendit të punës të mbajtur nga ankuesi dhe suprimimi i vendit të punës kishte ardhur si pasojë e një akt marrëveshje që Bashkia Selenicë kishte nënshkruar me Postën Shqiptare sh.a, Filiali i Postës Vlorë. Nga aktet e administruara rezultoi se, në datën 23.01.2020, Bashkia Selenicë dhe Posta Shqiptare sh.a, Filiali i Postës Vlorë, kanë lidhur një akt-marrëveshje e cila kishte si objekt kryerjen e shërbimit të arkëtimit të taksave dhe konkretisht: taksën e tokës bujqësore, taksën e gjelbërimit, taksën e pastrimit, taksën e ndriçimit dhe të gjitha taksat e tjera që ka bashkia me një afat 1 vjeçar.

Bazuar në marrëveshjen e mësipërme, e cila është vendosur edhe si referencë ligjore në urdhrin nr. nr. 14, datë 15.01.2020 “*Mbi strukturën organike për vitin 2020 dhe nivelin e pagave të punonjësve*”, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, është vendosur suprimimi i vendit të punës “*specialist finance*”. Referuar urdhrin të sipërcituar të kryetarit të Bashkisë Selenicë është urdhëruar suprimimi i të gjitha pozicioneve të punës “*specialist finance*” në Njësitë Administrative në juridiksionin e Bashkisë Selenicë dhe jo vetëm pozicioni i punës i mbajtur nga ankuesi.

Ankuesi pretendoi se marrëveshja me Filialin e Postës Vlorë ishte një justifikim me qëllim abuziv. Sipas ankuesit, punonjësi i shërbimit postar Vlorë do të kryejë vetëm një nga shumë detyrat që

kryente ankuesi si “specialist finance”. Pra punonjësi i postës, do të kryejë arkëtimin e disa taksave ndërsa detyrat e tjera të financës duhet të kryhen nga financieri, duke ngritur pikëpyetje se nga kush do të kryheshin këto detyra pas largimit të ankuesit nga puna. Në lidhje me këtë pretendim të ankuesit, Komisioneri vlerëson se, marrëveshja midis Filialit të Postës Vlorë dhe Bashkisë Selenicë ka shërbyer si motivacion për suprimimin jo vetëm të pozicionit të punës së ankuesit, por edhe të pozicioneve të tjera të ngjashme me të, në njësitë administrative në juridiksionin e Bashkisë Selenicë. Komisioneri vlerëson se, mënyra e organizimit dhe pozicionet e punës janë diskrecion i bashkisë, për sa kohë që ndrysimet në strukturë dhe suprimimi i pozicionit të punës “specialist finance”, ka ndodhur për të gjitha njësitë administrative të kësaj bashkie. Nga shqyrtimi i urdhrin nr. 28, datë 08.02.2021 “Për organikën dhe nivelin e pagave të punonjësve për vitin 2021”, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, rezulton se pozicioni i punës “specialist finance” në njësitë administrative të Bashkisë Selenicë, nuk figuron si pozicion pune, as në organikën e vitit 2021.

Nga informacioni dhe aktet e administruara, rezultoi se, si pasojë e ndryshimeve të mësipërme në strukturën e Bashkisë Selenicë, janë prekur ankuesi dhe punonjësi S.H, me detyrë “specialist finance”, në Njësinë Administrative Vllahinë. Në rastin e ankuesit Bashkia Selenicë, si pasojë e suprimimit të vendit të punës, kishte vijuar me procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin F.T, ndërsa deklaroi se punonjësin S.H, i cili ishte i punësuar në një pozicion të ngjashëm me ankuesin, e kishte sistemuar si punonjës tatimesh, pasi ky punonjës kishte statusin e nëpunësit civil, ndërsa marrëdhëniet e punës së ankuesit rregulloheshin nga Kodi i Punës.

Bazuar në akt-emërimin nr.1, datë 15.01.2020, të kryetarit të Bashkisë, rezultoi se punonjësi S.H, ishte emëruar “specialist finance”, në përfundim të procedurave të konkurimit të zhvilluara bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.243 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Në këtë akt nuk përcaktohet nëse punonjësi S.H është “specialist finance” pranë Njësisë Administrative Vllahinë, por referuar strukturës së bashkisë për vitin 2020, miratuar me urdhrin nr.14, datë 15.01.2020, ky punonjës figuron si “specialist finance”, pranë Njësisë Administrative Vllahinë.

Referuar strukturës së Bashkisë Selenicë për vitin 2020 (miratuar me urdhrin nr. 14/15.01.2020), nuk rezulton ndonjë pozicion pune me emërimin “punonjës tatimesh”. Bazuar në formularin e përshkrimit të punës në të cilin ishte sistemuar punonjësi S.H, pas suprimimit të pozicionit “specialist finance”, të vendosur në dispozicion nga Bashkia Selenicë gjatë seancës dëgjimore, rezulton se, pozicioni “punonjës tatimesh” i korrespondon pozicionit të punës i cili në strukturë pasqyrohet me emërimin “inspektor taksash”, në Inspektoriatin Tatimor të Kundravajtjeve Administrative, menaxhimin e Debitorëve, Konfiskimin dhe Sekuestrimin, në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave, Bashkia Selenicë. Formulari i përshkrimit të punës, i vendosur në dispozicion, nuk është i firmosur nga punonjësi S.H dhe eprori direkt. Referuar strukturës së bashkisë për vitin 2021, rezulton se emërtimi për pozicionin e mësipër të punës është “inspektor terreni”, respektivisht nga 1 punonjës të tillë për çdo njësi administrative.

Sa më sipër rezulton se pozicioni i punës “specialist finance” në njësitë administrative të Bashkisë Selenicë, është klasifikuar nga Bashkia si pozicion pune që i përket shërbimit civil. Për pozicionin e punës “specialist finance” në Njësinë Administrative Vllahinë, Bashkia Selenicë ka zhvilluar procedurat e konkurimit dhe në përfundim të tyre ka nxjerrë aktin e emërimit nr.1, datë 15.01.2020, për emërimin e punonjësit S.H. Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se, pavarësisht faktit që ankuesi dhe punonjësi S.H, kanë mabjtur pozicione pune të ngjashme, respektivisht ankuesi “specialist finance” në Njësinë Administrative Sevaster dhe punonjësi S.H, “specialist finance”, në Njësinë Administrative Vllahinë, në momentin që ka ndodhur suprimimi i pozicionit të punës, punonjësi S.H ka qenë i emëruar si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e sipërcituar.

Sistemimi i nëpunësit civil, pozicioni i të cilit nuk ekziston më për shkak të mbylljes ose ristrukturimit të institucionit, rregullohet nga neni 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në pikën 1, të nenit 50, të këtij ligji, përcaktohet se : *“Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori”*, ndërsa në pikën 6, të po këtij neni, përcaktohet: *“6. Përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së një institucioni, nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur, si pasojë e këtyre procedurave, ka shkurtim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe transferimi, sipas pikës 2 të këtij neni, është i pamundur”*.

Komisioneri nuk ka si objekt verifikimin e procedurave dhe ligjshmërinë e veprimeve të Bashkisë në lidhje me emërimin e punonjësit S.H si nëpunës civil apo respektimin e përcaktimeve të nenit 50, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar në lidhje me sistemimin e këtij punonjësi pas suprimimit të vendit të punës “specialist finance”, por konstaton se, detyrimi për sistemimin e punonjësit S.H dhe sistemimin e ankuesit, pas suprimimit të vendeve të tyre të punës, janë të ndryshme dhe për rrjedhojë ata nuk janë në pozitë të njëjtë ose të ngjashme.

Ankuesi nuk paraqiti asnjë pretendim në lidhje me faktin nëse, nga momenti i suprimimit të vendit të punës dhe largimit të tij nga puna, Bashkia Selenicë kishte punësuar punonjës të rinj, me një kualifikim të krahasueshëm/përafërt me ankuesin, pa i dhënë përparësi sistemimit dhe rimarjes në punë të ankuesit, për sa kohë rezulton që largimi nga puna i ankuesit ka ndodhur për arsye që nuk kanë të bëjnë me atë si punëmarrës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës ankuesi pretendoi se ai ishte punonjësi më i kualifikuar sa i përket arsimit dhe përvojës së punës dhe pavarësisht kësaj ai ishte larguar nga puna, ndërkohë që punonjës të tjerë edhe me arsim të mesëm vazhdonin punë. Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi motivi i largimit nga puna të ankuesit është suprimimi i vendit të punës dhe jo kualifikimi arsimor, e për rrjedhojë krahasimi që bëhet nga ankuesi midis nivelit të tij arsimor dhe punonjësve të tjerë në Njësinë Administrative Sevaster, është i papabuar. Niveli arsimor i

punonjësve duhet të përputhet me kërkesat e vendosura për pozicionet respektive të punës, por, nëse për një pozicion pune kërkohet arsimi i mesëm, kjo nuk do të thotë që një person me arsim të lartë ta pretendojë këtë pozicion pune thjesht për faktin se niveli i tij arsimor është më i lartë, ndërkohë që niveli arsimor i punonjësit të punësuar në këtë vend pune përputhet me kriterin arsimor të vendit të punës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, ndryshe nga sa pretendoi Bashkia Selenicë, se ajo kishte respektuar procedurën e parashikuar nga Kodi i Punës dhe se zgjidhja e kontratës ishte bërë për shkaqe të justifikuara, sikundër edhe gjykata ka konstatuar me vendimin nr.710, datë 28.04.2021, rezultoi se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin me motivacionin “suprimim i pozicionit”, nuk përlligj kërkesat e Kodit të Punës (neni 153) për t’u konsideruar si shkak i justifikuar, në mënyrë që të legjitimonte veprimin e bashkisë për zgjidhjen e kontratës në mënyrë të menjëhershme. Zgjidhja e kontratës së punës për shkak të ristrukturimit apo suprimimit të pozicionit të punës përbën shkak të ligjshëm për të cilin mund të zgjidhet kontrata, por në këtë rast punëdhënësi duhet të respektojë procedurën dhe afatet e parashikuara nga Kodi i Punës. Gjithashtu, nga aktet e administruara, ndryshe nga sa u pretendua nga Bashkia Selenicë gjatë shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit, Bashkia Selenicë edhe pse kishte barrën e provës, nuk arriti të provojë se kishte respektuar procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës, sipas kërkesave të nenit 144, të Kodit të Punës. Me shkresën nr.1094 prot., datë 24.03.2020 “Njoftim për fillimin e procedurave të ndërprerjes së marrëdhënies së punës”, Bashkia Selenicë ka njoftuar ankuesin për zhvillimin e takimit brenda 72 orëve, nga marrja e njoftimit, por nuk provoi që ky takim të ishte zhvilluar. Thjesht, shkresa për njoftimin e procedurave të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nuk provon se Bashkia ka respektuar procedurën e parashikuar nga neni 144, i K.Punës.

Përsa më sipër, pavarësisht nëse Bashkia Selenicë, nuk ka respektuar procedurën dhe afatet për zgjidhjen e kontratës së punës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës, kjo situatë nuk e ka vendosur ankuesin në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme në raport me të tjerë.

Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Selenicë, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se nga ana e Bashkisë Selenicë, janë shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit F.T, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Selenicë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim